

Dr. Rexhep Munishi, *Identiteti muzikor* - Prishtinë 2001, 314 faqe

Etnomuzikologu Dr. Rexhep Munishi është studiues i afirmuar i krijimtarisë muzikore të traditës. Nga lëmi i studimeve etnomuzikologjike, botoi deri më tani disa vepra me studime të zhanreve të krijimtarisë muzikore të traditës, të cilat janë specifike si për nga struktura e këndimit (melodisë), ashtu edhe nga struktura tekstore.

Në veprën e *Këndimi i femrave të Podgurit*, (1979) autori studion zhanret muzikore të krijuara dhe të kënduara nga femrat, ku kryesisht trajtohen këngët lirike. Vlen të theksohet se njëra ndër format veçuese është këndimi i bareshave me gisht në fyt. Është kjo një formë shumë karakteristike dhe autoktone e këndimit. Këngët e këtij studimi janë të melografuara dhe të analizuara në rrafshin melodik dhe në atë tekstor dhe kuptimor, gjithnjë duke e pasur parasysh kontekstin e situatës dhe ligjshmëritë e lindjes dhe bartjes së kësaj krijimtarie.

Vepra tjetër, *Këngët malësorçe shqiptare* (1987), është studim i thelluar për këngët malësorçe, apo këngët me gisht në vesh, formë kjo arkaike dhe autoktone e të kënduarit, e cila ruan lidhjet me kohët e lashta. Ky lloj i të kënduarit specifik ishte përdorur edhe si formë e komunikimit. Studimi ka vlerë të veçantë, meqë i kushtohet një cikli këngësh që tanimë konsiderohet i mbyllur.

*Probleme etnomuzikologjike* (1997), është vepër që merret me studimin e zhanreve të veçanta dhe të formave të ndryshme të këndimit, me studimin e krijimtarisë së shkruar – kompozuar muzikore, si dhe me çështje të tjera të krijimtarisë muzikore aktuale.

Munishi merret edhe me studimin e krijimtarisë muzikore korale.

Si rezultat i kësaj pune është vepra *Krijimtaria korale shqipe në Jugosllavi* (1988).

Së fundi Dr. Rexhep Munishi botoi veprën *Identiteti muzikor*, në të cilën trajtohen një shumësi çështjesh të fushës së etnomuzikologjisë, muzikologjisë dhe të kulturës muzikore përgjithësisht. Nga leximi i vëmendshëm del se veprën e përshkon një qëllim, i cili ndërthuret si një ind i tejdukshëm, që nga këndvështrimi i etnomuzikologut synon ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të krijimtarisë muzikore të traditës. Në të vërtetë, aimerr në vështrim krijimtarinë muzikore që krijohet në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX, e cila pretendon të quhet muzikë popullore. Kjo krijimtari muzikore mori kahe të zhvillimit jo të natyrshëm dhe bëri ndikim negativ që shpie në shkatërrimin e vlerave muzikore kombëtare, të krijuara dhe të bartura nëpër shekuj, të cilat u kanë rezistuar edhe ndikimeve të pushtuesve shekullor.

Ky shkatërrim bëhet në mënyrë eruptive nga “shkruesit, krijuesit” dhe bartësit e saj. Si dukuri është shumë shqetësuese, prandaj, me të drejtë autori më shumë se dhjetë vite bën përpjekje me shkrimet, studimet dhe sugjerimet e veta profesionale, të ndikojë që kjo krijimtari muzikore, e cila pretendon të quhet muzikë popullore shqiptare, të mos i dëmtojë rrjedhat kombëtare. Muzika e tillë mbështetet kryekëput në melosin turk, arab, indus, jevg, sllav, grek etj., duke krijuar një muzikë hibride, që mund të quhet çdo gjë, por muzikë shqiptare assesi jo.

Punimet dhe vështrimet e këtij libri, autori i sistemon në tetë kapituj, të cilëve u prin parathënia dhe një punim i

titulluar *Shtresat e muzikdashësve para një dekade* dhe pasthënia.

*Dhuna mbi kulturën dhe artin* është kapitulli i parë ku preokupim i autorit është mbyllja dhe shkatërrimi i institucioneve kulturore, arsimore, shkencore, muzikore dhe i mediave, si pasojë e dhunës politike të krijuar gjatë atij dhjetëvjetëshi. Rrënimin e dhunshëm të institucioneve muzikore autori e konsideron si dukuri që i solli shumë dëme kolektivitetit shqiptar. Shuarja e institucioneve muzikore, e mediave dhe e organizmave të veçantë siç ishin, bie fjala, orkestra simfonike, RTV, festivalet e ndryshme e të muzikës e të traditës fshatare, të muzikës popullore qytetare, të muzikës serioze dhe të muzikës së lehtë, shkaktuan një heshtje dhe vakum, që për pasojë pati shfaqjen e një krijimtari muzikore e cila lansohej nëpërmjet video dhe audiokasetave, muzikës së kafeneve, që përhapej me shpejtësi të rrufeshme. Qëllimi kryesor i krijuesve dhe interpretuesve të saj, në kohën kur u shuan institucionet legale, ishte përfitimi material i pseudokrijuesve. Autori shkruan me kompetencë dhe alarmon për rrezikun që po kanosej me propagandimin dhe lansimin e një muzike pa kurrfarë vlerash artistike, e cila synonte që të afirmohej kinse në emër të patriotizmit.

Analizohen shkaqet e shfaqjes së kësaj dukurie shkatërrimtare në punimet: *Rrënimi i institucioneve muzikore, Shkatërrimi i arsimit muzikor, Prania e llojeve të muzikës në aktualitetin tonë, Etika dhe morali i krijuesit – interpretuesit muzikor, Çfarë janë raportet në mes muzikës dhe politikës*, për të dalë në analizën e hollësishme dhe kritikën e hapur që i bën krijimtarisë muzikore, “krijuesve” të

saj dhe interpretuesve të cilët në video dhe audio kasete, në koncerte dhe kafene përhapin dhe ekzekutojnë një muzikë pa kurrfarë vlerash artistike, një muzikë eklektike të krijuar nga muzika e popujve të ndryshëm. Kjo muzikë, që pretendon të quhet muzikë e re popullore e kompozuar, kishte për qëllim ndezjen e ndjenjave në një kohë depresive të situatës së rëndë politike. Shpresohet se kjo dukuri, e cila zvarritet dhe po i shtrin rrënjët gjithnjë e më shumë, nuk do të zgjasë shumë. Ky lloj i muzikës, në vend që të ketë synim fisnikërimin dhe nxitjen e ndjenjave estetike të marrësi, ka për qëllim, kinse në emër të ndjenjave patriotike, t’i ndezë ndjenjat dhe ta sentimentalizojë shpirtin me melizma orientale, me klithma dhe ofshamje që në esencë nuk shkaktojnë kurrfarë kënaqësie estetike, përkundrazi nxisin depresion shpirtëror. Muzika e tillë largohet gradualisht nga kombëtarja dhe i afrohet muzikës mikste nga popujt e ndryshëm, e cila shpie në *dekulturim, akulturim apo transkulturim*, që do të thotë, harrim i vetvetes, i kulturës dhe i muzikës kombëtare, i asaj pjese që na shquan si komb me një traditë dhe kulturë të lashtë vetanake dhe origjinale.

Autori me të drejtë ngrit zërin kundër kësaj dukurie, u drejtohet “krijuesve” dhe përhapësve të saj me kritika të rrepta me qëllim që krijimtarinë muzikore ta kthejë në shtratin kombëtar, duke sugjeruar shfrytëzimin racional të pasurisë sonë muzikore të traditës.

*Për krijues dhe veprimtarë të muzikës* është kapitulli ku autori trajton veprimtarinë muzikore të disa krijuesve dhe kompozitorëve, si dhe të pedagogëve të muzikës sonë. Ai pastaj shkruan për traditën e lashtë muzikore,

që nga mesjeta e hershme, duke filluar nga Niketë Dardani, i cili kishte bërë emër në Evropë me muzikën e tij të përshpirtshme, për të vazhduar me shkrimet për krijimtarinë e studiuesve të muzikologjisë dhe të etnomuzikologjisë dhe me disa vlerësime për veprimtarinë gazetareske muzikore.

Duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me studimet etnomuzikologjike, muzikologjike dhe me krijimtarinë muzikore, ai u bën vështrim veprave të botuara nga këta lëmenj. Në vështrimet e tilla të karakterit kritik heton vlerat e atyre veprave, të cilat synon t'ua bëjë sa më të afërta studiuesve dhe lexuesve, si dhe t'i afirmojë ato, qofshin studime të veçanta, tekste mësimore, përmbledhje këngësh me vlera të mirëfillta apo edhe krijime të kompozuar, siç janë, bie fjala, këngët korale për Nënë Terezen.

Kapitulli *Muzika-lufta-muzika*, ka objekt trajtimi krijimtarinë popullore muzikore me temën e luftës. Këtu trajtohet edhe gjendja e rëndë në të cilën, për një kohë, u hesht edhe muzika. Pas përfundimit të luftës u krijuan një sërë këngësh me këtë tematikë, në të cilat për t'u krijuar një atmosferë kinse sa ma epike në përcjelljen muzikore përdorej vend e pa vend tupani (daullja), përdorimi i tepërt i të cilit, sipas autorit, lëndon natyrshmërinë e këngëve, meqë në traditën tonë muzikore daullja është përdorur në përcjelljen e valleve.

Kapitulli i titulluar *Tema sociomuzikore*, trajton tema dhe çështje nga lëmi i muzikologjisë, të cilat lidhen kryesisht me mentalitetin që dominon ndër ne për çështje të ndryshme muzikore. Këtu trajtohen edhe çështje të tjera që lidhen me ruajtjen, ngritjen dhe afirmimin e identitetit tonë kombëtar

nëpërmjet ngritjes dhe mbëkëmbjes së institucioneve muzikore, siç janë: Ansambli Shota, Shoqata e Kompozitorëve, Orkestra Simfonike etj. Në punimet e tilla synohet institucionalizimi i veprimtarisë muzikore, kultivimi i asaj krijimtarie që ka vlera të mirëfillta artistike.

Kapitulli *Vështrime teorike për këngë të reja dhe valle të koreografuara*, ka objekt shqyrtimi krijimtarinë muzikore që mëton të quhet folklorike, e cila synon të kualifikohet si muzikë popullore e traditës, sado që struktura e saj melodike dhe tekstore nuk përkon me të. Ai bën objekt trajtimi edhe vallet e koreografuara, që shfaqen në skenë dhe në videokaseta. Vallet që kanë mbështetjen në kërcim apo vallet popullore, thuhet se duhet ta ruajnë natyrshmërinë e lëvizjeve, të gjesteve dhe të mimikës dhe të jenë në harmoni me gjininë apo zhanrin që i përkasin; e njëjta gjë duhet të ndodhë edhe me melodinë. Merret në vështrim edhe një dukuri që shfaqet si "dekor" gjatë interpretimit të këngëve popullore, me ç'rast shfaqen disa vallëzues apo vallëzuese, vallëzimi i të cilëve nuk përkon me natyrën e këngëve, ndërsa veshjet kombëtare defunksionalizohen dhe çoroditen.

Kapitulli i fundit trajton tema të ndryshme muzikore. Këtu vlen të theksohet punimi ku autori përpiqet të na krijojë një parafytyrim për muzikën në kohën e mbretëreshës Teutë. Duke qenë njohës i mirë i muzikës, ai insiston që nga shkrimet letrare, siç është, bie fjala, romani *Ilirja* i shkruar nga Flora Dozan të nxjerrë disa shënime për muzikën dhe vallëzimin në kohën e mbretëreshës Teutë. Trajtohen edhe tema të tjera për muzikën, për artistët muzikorë, për operën, por edhe për lahutën si instrument që e shoqëron gjithnjë këngën epike. Kjo vegël ia ka imponuar

tonin dhe ritmin kësaj krijimtarië. Theksohet se lahuta në bashkinterpretim me zërin krijon një shkallë të parë të këndimit polifon popullor; ajo krijon heterofoni që ka domethënie në jetën e mjedisit të caktuar. Edhe pse me një diapazon (ambitus) të ngushtë të tingujve, lahuta krijon mundësi të madhe të shprehjes, ku sintetizohet arti i fjalës me artin muzikor dhe herë-herë me artin dramatik. Ky kapitull mbyllet me disa vështrime të shkruara pas kthimit të shqiptarëve nga ekzodi me përmasa mitike. Shfaqet shpresa se muza e muzikës do të zgjohet pas gjithë atyre vuajtjeve që i pësoi kolektiviteti shqiptar gjatë tërë decades së fundit dhe gjatë luftës. Autori ka besim e shpresë se pas tërë kësaj amullie dhe shterpësie muzikore duhet të krijohet muzika e mirëfilltë, qoftë ajo e traditës burimore, qoftë ajo e muzikës serioze. Krijuesit, bartësit, interpretuesit dhe reprodukuesit, sipas autorit, duhet t'u kthehen vlerave kombëtare me qëllim të ruajtjes së identitetit muzikor-kombëtar.

Optimizmi i autorit shprehet në punimet në të cilat u bën vështrim disa dukurive që sinjalizojnë kthimin e muzikës në rrjedhat e saja të mirëfillta. Kjo shihet me përpjekjet për formimin e orkestrës simfonike, me shfaqjen e veprave të ndryshme të kompozitorëve të njohur botërorë, si dhe me shfaqjen e ansamblit të muzikës kamertale etj.

Në tërësi kjo është një vepër me vlerë e shkruar nga njohësi dhe studiuesi i krijimtarisë muzikore që insiston për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave muzikore kombëtare, me të cilat dëshmohet identiteti muzikor por edhe kombëtar, për krijimin dhe kultivimin e shijes për muzikën e shkruar artistike, e ashtuquajtur serioze. Vepra është shkruar me një gjuhë sa profesionale po aq edhe të lehtë dhe të kuptueshme, ku ofrohen informacione jo vetëm për kulturën muzikore, por edhe për dukuri të ndryshme kulturore, përgjithësisht.

Myzaferre MUSTAFA